

Shoqëria "ADG" shpk (Lufra), pjesë e grupit "LUFRA FOODS", që prodhon dhe shpërndan produktet me te njofura si : produktet e bulmetit "Lufra", "Tido", "Tradita", "Beneta" dhe uji "Dukat Water".

Gjithashtu ne jemi edhe distributorë ekskluziv te produkteve të njohura rajonale dhe ndërkombëtare si: produktet e bulmetit "Cremona", "Bonizzi", "Nom", "Bylmeti" lengjet e frutave "Jaffa Champions", birra "Estrella Damm", pijet alkoolike si: "Heymans", "Komos Tequila", pijet "The London Essence" e shume produkte te tjera qe do te behen pjese e portofolit tone.

Aktualisht për aktivitetin në qytetin e Lushnjes, kërkojmë të punësojmë: Menaxher i departamentit të logjistikës.

Shoqëria jonë ofron kushte shumë të mira pune, një ambjent zhvillues në fushën profesionale nëpërmjet dinamikave të shumëllojshme të punës e stafit mbështetës si dhe një pagë konkurruese në treg.

Detyrat kryesore:

- Planifikimi dhe optimizimi i route. Nderton "route" eficente qe te minimizojë kohen dhe koston e dergimit te porosive;
- Ndjekja e flotes dhe monitorimi. Monitoron me ane te GPS per te ndjekur levizjet dhe performancen e mjeteve, kujdeset qe mjetet perdoren ne menyre efektive dhe te sigurt;
- Menaxhimi porosive. Rishikon vazhdimisht procesin e porosive per t'u siguruar qe porosite jane pergatitur ne rregull dhe dorezuar ne kohen e duhur;
- Raportimi. Ndjek dhe raporton dergesat e porosive ne kohe. Ndjek konsumin e mjeteve ne baze te raportit te dakortësuar dhe performancen e shoferave;
- Menaxhimi i kostove. Arkivon dhe perpunon te dhenat mbi koston e transportit, duke perfshire: karburantin dhe pagat e shoferave duke punuar gjithmone ne optimizimin e tyre;
- Koordinimi. Koordinon me magazinën, mirembajtjen dhe shitjen qe te sigurojë mbarevajtje te mire te operacioneve;
- Menaxhimi i inventarit. Ndjek stokun, skadencat dhe distributimin e produkteve ne te gjitha magazinat e shoqërisë;
- Supervizimi stafit. Eshte pergjegjes per: trajnimet dhe menaxhimin e stafit te magazinave dhe shoferëve qe ka ne varesi, duke perfshire ketu: rregullimet e orareve/turneve, vleresimet e performances dhe sigurohet qe stafi te jete i trajnuar per operacionet dhe procedurat;
- Kontrolli i cilesise. Sigurohet qe magazinat te jene ne gjendje te mire dhe kontrollon proceset e cilesise per te shmangur demtime ose humbje;
- Buxheti. Menaxhon dhe kontrollon buxhetin duke u kujdesur qe te mos e tejkalojë ate;
- Pajisjet dhe ndertesa. Rishikon dhe kujdeset per mirembajtjen e mjeteve te magazines (pirun, transpaleta etj) qe te jene ne gjendje te mire pune;
- Implementimi teknologjise. Shfrytëzon sistemet e menaxhimit ne menyren me te mire qe te permiresojne korrektesen e proceseve dhe raporteve;

- Koordinimi me shitesit dhe furnizuesit. Koordinon me furnizuesit dhe kompanite e transportit qe te siguroj pranimin dhe dergimin ne kohe te mallrave.

Kualifikimet e kandidatit:

-Eksperiençë punë te paktën 3 vite në pozicione të ngjashme;

-Njohje e mirë e paketës Microsoft Office;

-Njohje shumë të mira të gjuhës Angleze;

-Të ketë aftesi organizative dhe koordinimi;

-Të jetë i komunikueshem dhe i aftë të punoje në grup.

Preferohen kandidatë qe kane vendbanim ne qytete si : Lushnje, Fier, Berat dhe zonat perreth.

Për të aplikuar për këtë pozicion pune, ju lutem të dërgoni CV-në tuaj në adresën e E-mail: hr@lufra.al ose kontaktoni ne nr e telefonit +355 69 707 3674.

Cel. : 069 707 3674